

SEKTORI ENERGETIK I KOSOVËS

Hyrje.....	1
1. Energjia në Botë.....	1
2. Energjia në Kosovë.....	1
3. Burimet e Energjisë.....	2
3.1. Thëngjilli.....	2
3.2. Energjia Elektrike.....	3
3.3. Gazi Natyror dhe Nafta.....	3
3.4. Energjia e Ripërtrirë.....	5
4. Politikat Energjetike në Botë dhe në Kosovë.....	5
5. Tregu i Energjisë Elektrike.....	8
5.1. Çmimet e Energjisë Elektrike.....	8
5.2. Prodhimi i Energjisë Elektrike	9
5.3. Konsumimi i Energjisë Elektrike.....	10
5.4. Eksportimi dhe Importimi i Energjisë Elektrike.....	12
5.5. Humbjet në Sektorin e Energjisë Elektrike.....	12
6. Aktivitetet e Sektorit të Energjisë Elektrike në Dispozicion.....	13
7. Rrjeti i Transmetimit dhe Shpërndarjes.....	15
8. Bilanci i Energjisë: Shpërndarja Sektoriale dhe Burimore e Furnizimit dhe Kërkesës së Energjisë Totale 2009.....	
9. Rritja e Efikasitetit të Energjisë.....	15
10. Rëndësia e Energjisë dhe Teknologjisë.....	16
11. Energjia dhe Mjedisi.....	16
12. Projektet e planifikuara.....	17
Përfundim.....	18

HYRJE

Që nga formimi Oda Tregtare Kosovare Turke (OTKO), ka ndikuar në zhvillimin e mardhënieve ekonomike në mes dy shteteve, njëherazi ka ndikuar edhe në rritjen e vëllimit në tregëti dhe me qëllim të sjelljes së investimeve në rajon, ka organizuar forume biznesi, seminare si dhe ka aranzhuar takime dypalëshe.

Në bazë hulumtimeve që janë bërë në përgjithësi apo në ndarje sektoriale, është vërejtur nevoja edhe për disa të dhëna shtesë. Me kontributin e TIKA'se, në kuadër të Oda Tregtare Kosovaro Turke (OTKT) , janë aranzhuar Tendencia Ndërkombëtare në Ekonominë Globale dhe Konferenca e Mjedisit të Kosovës, ne duke e vlerësuar Ekonominë Globale , në anën tjetër është duke u punuar rregullimi i mjedisit të Kosovës. Si rrjedhë e kësaj , në Kosovë si potenciali i investimeve , ashtu edhe rëndësia e tyre, disa sektore janë të dalluar. Në kuadër të Odës, në emër të biznesmenëve dhe investitorëve për vlerësimin e potencialit në Ekonomin Kosovare më afër , dhe për punimet të cilat mendojmë që për ju do të jenë si njohuri , kemi shtypur katër doracak .

Në serialin e parë të publikimeve të OTKT'së, mund të gjeni të dhëna ne katër fusha siç janë: Ekonomia Kosovare, Energjetika, Bujqësia dhe sektori i ndërtimtarisë.

Me nderime

Oda Tregtare Kosovaro Turke

HYRJA :

Për mbështetjen e zhvillimit të vendeve , jetës së njeriut dhe nevojave të përgjithshme është shumë e rëndësishme që sektori i energjisë të zhvillohet paralel me këto. Në sektorin e energjisë duhet të planifikohen kërkesat , furnizimi , transmetimi , shpërndarja , lëndët djegëse dhe tarifat gjithashtu objektivi kryesor i vendeve është minimizimi i problemeve që mund të shkaktojnë pakënaqësi tek konsumatori. Përdorimi i gjërë i energjisë elektrike është i rëndësishëm në aspektin e zhvillimit njerëzor.

Nga të gjithë sektorët social të energjisë dhe energjisë elektrike kërkon furnizim të vazhdueshëm të burimeve kombëtare në një përdorim efikas. Reduktimi i humbjeve komerciale në sektorin e energjisë në përmirësimin e fushës së shpërndarjes është çështje kryesore e sektorit. Meqë Kosova nuk ka pasuri të naftës dhe gazit natyror , prodhimin e energjisë e bënë të bazuar në një masë të madhe të linjtit. Termocentralet nuk mund të punojnë me një kapacitet të plotë për shkak të kufizimeve të furnizimit me linjit dhe pjesërisht për shkak të problemeve elektrike dhe mekanike të termocentraleve. Prandaj sektori i energjisë ,veçanërisht me aktivitetet e fundit të investimeve të reja dhe me furnizimin deficit mban pozitën e tij në rendin e ditës.

Projektet Termike dhe Hidroelektrike me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare si një politikë udhëheqëse në Kosovë, janë shpresdhënëse.

1. ENERGJIA NË BOTË

Në botë në përgjithësi burimet e furnizimit me energji janë nafta , gazi natyror dhe qymyri. Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë në vitin 2030 pritet të mbeten si bazë të njëjtat burime të furnizimit me energji. Prandaj sikurse sot pjesa më e madhe e furnizimit me energji supozohet të mbetet nafta me 35 % . Nafta dhe Gazi natyror 25 % , mesatarisht me 22 % e ndjekur nga qymyri. Burime të tjera të energjisë janë 11.3 % druri , 2.2 % hidrocentralet e energjisë , të drurit , diellore , nukleare ,etj.

Në botë përse i përket burimeve të energjisë , vendet në zhvillim , rritja e shpejtë ekonomike dhe për shkak të rritjes së popullsisë dhe normave të urbanizimit është në gjendje të prodhojë gjysmën e totalit të kërkesës për energji. Prandaj për të përmbushur kërkesën për energji rritet varësia e bashkëpunimit me rajonet e botës të cilat kanë sasi të mjaftueshme të naftës dhe gazit natyror.

Qymyri në mbarë botën , nuk tregon ndonjë ndryshim të rëndësishëm në furnizim me energji elektrike.

2. ENERGJIA NË KOSOVË

Pothuajse i gjithë sektori i energjisë elektrike në Kosovë është i bazuar në energjinë elektrike. Ky fakt është një problem për sektorin e energjisë. Veçanërisht gjatë muajve të

dimrit për të përmbushur kërkesën për energji elektrike , ajo importohet nga vendet fqinje. Për shkak të financimit të pa mjaftueshëm dhe dështimeve teknike në vitet e '90-ta mirëmbajtja dhe punimet e rehabilitimit të termocentraleve dhe linjtit, nuk është rritur prodhimi i energjisë elektrike. Gjatë viteve 1999 – 2008 në kuadrin e investimeve të rëndësishme është bërë përmirësimi i performancës së termocentralit të Kosova B, po ashtu është bërë edhe rritja e cilësisë së energjisë totale të prodhuar. Është ndarë burimi për zhvillimin e rrjeteve të shpërndarjes së Termocentralit Kosova A .

Burimi kryesor i energjisë në Kosovë është linjiti. Kosova zë vendin e pestë në botë për rezervat e linjtit e cila ka 14.7 ton të rezervave të linjtit. Burimet e ujit për konvertim në energji janë të pamjaftueshme , në menyrë efektive të padisponueshme. Megjithatë , për themelimin e hidrocentralit dhe vënien në funksion ka përfunduar projekti dhe studimet e fizibilitetit.

Në anën tjetër , kur shikojm energjinë e përdorur për ngrohje në shtëpi , shofim këto të dhëna : 42 % dru , 38 % energji elektrike , 15 % naftë , 3 % ngohje qendrore , 2 % GLN dhe të tjera. Përdorimi i ulët i gazit natyror rrjedh nga mungesa e ekzistimit të qasjes së rrjetit të gazit natyror. Shkaku kryesor i ngrohjes me dru gjatë muajve të dimrit është për shkak të energjisë elektrike të bezdisshme.

3. BURIMET E ENERGJISË

3.1 THËNGJI

Kosova është një vend i pasur me qymyr. Sektori i energjisë është i bazuar në sasi të lartë, në cilësinë mesatare të linjtit lokal. Nga këto dy miniera çdo vit mesatarisht nxirren 6.44 milion ton qymyr. Mirëpo , rezervat e linjtit të përdorura që nga viti 1958 nga këto dy miniera janë në rënie. Qëllimi për zhvillimin rajonal është rritja e sasisë së linjtit të nxjerrur nga miniera e Siboticës. Gjithashtu termocentrali i ri i cili do të krijohet do të përdor depozitat e linjtit.

Pothuajse i gjithë prodhimi i energjisë në vend në termocentralet Kosova A dhe Kosova B bëhet nga linjiti i qymyrit të nxjerrur. Kur merren parasysh rezervat dhe transporti i naftës dhe gazit natyror në botë , qymyri vazhdon të jetë burimi kryesor i energjisë. Përveç kësaj qymyri tregoi një përhapje më të gjërë në gjithë botën në krahasim me naftën dhe gazin natyror.

Vitet e prodhimit të qymyrit në Kosovë :

2004	5.658,4	-12,49 %
2005	6.391,1	12,95 %
2006	6.532,4	2,21 %
2007	6.715,4	2,80 %
2008	7.842,9	16,78 %
2009	9.166,9	16,97 %

2009: 1,460.72
ktoe

Burimi i

informacionit : Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Nga kërkesa e rritur për energji dhe përmirësimet e bëra në termocentrale është vërejtur një rritje në minierat e qymyrit të nxjerrur. Me hyrjen në prodhimt të termocentraleve të reja dhe hapjes së depozitave të reja pritet të ketë rritje në prodhimin e qymyrit.

3.2 ENERGJIA ELEKTRIKE :

Meqë energjia alternative në Kosovë është shumë e shtrenjtë , konsumatorët më shpesh përdorin energjinë elektrike. Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga Korporata Energjetike e Kosovës. Mesatarja vjetore e energjisë elektrike të prodhuar është 3,80 milion MWh. Që nga viti 1990 , tarifat e energjisë elektrike janë rritur me një normë të ulët dhe të qëndrueshme. Për shkak të numrit të madhë të konsumatorëve që shfrytëzojnë energjinë elektrike në mënyrë ilegale në Kosovë dhe mospagimit të faturave shkaktohet humbje e rëndë e energjisë elektrike.

Sipas shifrave të Korporatës Energjetike të Kosovës në vitin 2008 në Kosovë: 7,842.037 ton qymyr si burim primar , burimi i dytë i prodhimt të energjisë elektrike 4.505.692 MWh , 647.475 MWh të importit të energjisë elektrike , 234.976 MWh të eksportit të energjisë elektrike janë realizuar. Që nga viti 2008 në vendet publike është bërë konsumimi i 1.666.940 MWh të energjisë elektrike kurse konsumimi komercial ishte 1.273.998 MWh.

3.3 GAZI NATYROR DHE NAFTA :

Në Kosovë nuk ka burime të naftës dhe gazit natyror. Për të përmbushur nevojat e naftës dhe gazit natyror bënë importimin e tyre.

Në përgjithësi gazi natyror përdoret në sektorët industrial dhe pjesërisht në transport. Një pjesë e rëndësishme e strategjisë së sektorit të energjisë në Kosovë është hetimi i zhvillimit të gazit natyror në të ardhmen dhe vlerësimi i mundësive. Për të zvogeluar varësinë ndaj energjisë elektrike dhe për të forcuar infrastrukturën e energjisë , Ministria e Energjisë dhe Minierave së bashku me sekretariatit e Bashkimit të Energjisë (ENC) kanë kryer punët për furnizim me gaz natyror në të ardhmen .

Vitet e importit të gazit natyror në Kosovë :

Vitet	Importi i gazit / (mije) ton	Normat e importit të gazit gjatë vitit të kaluar
2004	9.057,1	-
2005	13.694,2	51,19 %
2006	19.394,7	41,63 %
2007	25.208,4	29,96 %
2008	31.567,2	25,22 %

Burimi i informacionit : Statistikat e Tregtisë së Jashtme – Zyra e statistikave në Kosovë (ESK)

Rritja e përdorimit të naftës dhe derivateve në sektorin e transportit dhe nevoja e furnizimit të sektorëve industrial kanë çuar në rritje të importit.

Vitet e importit te naftes ne Kosove :

Vitet	Importi naftës / (mije) ton	Normat e importit të naftës gjatë vitit të kaluar
2004	363.546,5	-
2005	352.939,6	-2,92 %
2006	357.497,4	1,29 %
2007	370.962,0	3,77 %
2008	422.496,3	13,89 %

Burimi i informacionit : Statistikat e Tregtisë së Jashtme – Zyra e statistikave në Kosovë (ESK)

3.4 ENERGJIA E RIPËRTËRIRË

Identifikuar si një burim i energjisë së ripërtërirë , energjia e erës, energjia diellore , energjia hidrike , bio energjia , energjia gjeotermale meqë vazhdimisht ripërtërihen domethënë nuk harxhohen , quhet energji e ripërtërirë. Duke pasur parasysh pashmangshmërinë e boshatisjes së rezervave të burimeve botërore primare të energjisë është kuptuar më mirë rëndësia e energjisë së ripërtërirë. Zhvillimi më i rëndësishëm i kësaj fushe është burimi i energjisë së erës. Nga burimet e energjisë së ripërtërirë burimi i cili prodhon energji më të madhe është ajo e hidrocentraleve e cila prodhon energjin elektrike.

Për shkak të prodhimit të kufizuar në Kosovë , rritjes së kërkesës për furnizim me energji çdo vitë dhe duke pasur parasysh burimet e tanishme minerale , energjia e ripërtëritshme shihet se ka mbetur në rëndësinë dytësore. Prioritet kryesor me përdorimin e linjtit është rritja e prodhimit të energjisë.

4.POLITIKAT ENERGJETIKE NË BOTË DHE KOSOVË DHE LEGJISLACIONI

Si rezultat i politikave të reja në sektorin e energjisë në vitet e '80-ta , me kalimin e implementimit të tregut ka çuar në mungesën e investimeve në sektorin e energjisë. Me aplikimin e tregut , investitorët privat në stabilizimin makroekonomik dhe në vendet ku projektet kanë rrezikshmëri më të ulët janë të gatshëm për të investuar. Veçanërisht shtetet të cilat janë në zhvillim , jostabiliteti makroekonomik dhe rreziku i pranishëm mundësojnë që në këto vende investimet e energjisë të bëhen të paçarta. Zvogëlimi i investimeve dhe rritja e vazhdueshme e kërkesës për energji kanë çuar në rritje të çmimit të energjisë.

Në përgjithësi në vendet në zhvillim politikat e privatizimit në sektorin e energjisë nuk kanë qenë të suksesshme. Si rezultat i privatizimit , për shkak të mospagesës së faturave të abonenteve bëhet ndërprerja e lidhjes elektrike dhe shkakton probleme në furnizim me energji elektrike.

Tre objektivat themelore të politikave të energjisë në mbarë botën janë : sigurimi i furnizimit me energji, dëme minimale për mjedisin dhe sigurimi i konkurrencës në furnizimin me energji. Mendimi i përgjithshëm është se për sektorin e energjisë janë të nevojshme politikat afatgjata , por si rezultat i aplikimit të tregut sektori privat rrezikon aplikimin e politikave afatgjata andaj autoriteti publik duhet të ushtrojë kontroll të fuqishme në sektorin privat.

Kosova , në kuadër të menaxhimit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) në Kosovë , duke krijuar një lidhje me komunitetin e energjisë në tregun e brendshëm të energjisë së Bashkimit Evropian , është një shtet palë. Marrëveshja e komunitetit të energjisë ka hy në fuqi më 1 Korrik 2007. Qëllimi i përgjithshëm është për të krijuar një kornizë të qëndrueshme dhe rregullative në treg , për tërheqjen e prodhimit të energjisë dhe investimeve elektrike , për të siguruar rrjete të qëndrueshme dhe të vazhdueshme të gazit , për të pasur një treg të integruar të lidhur me tregun e Bashkimit Evropian është e nevojshme krijimi i një tregu energjetik , mundësia e sigurimit të furnizimit me energji dhe rritja e performancës së sektorit të energjisë.

Marrëveshja e Komunitetit të Energjisë e bënë të obligueshme implementimin e pjesëve themelore të Legjislacionit të Bashkimit Evropian. Në veçanti përfshinë , masat mbrojtëse për tregun e energjisë dhe gazit dhe në investimet e infrastrukturës të bëhet përdorimi i standardeve teknike të Bashkimit Evropian. Marrëveshja gjithashtu , obligon zbatimin e legjislacionit edhe për çështjet e mjedisit.

Prodhimi , shpërndarja dhe mirëmbajtja e energjisë në Kosovë bëhet nga Korporata Energjetike e Kosovës. Me fillimin e luftës në vitin 1999 dhe ndërhyrjen ushtarake janë bërë dëmtime në rrjetin e shpërndarjes së energjisë dhe në objektet e ndërtimit. Prandaj pas luftës është konsideruar e nevojshme ristrukturimi i këtyre dy fushave.

Korporata Energjetike e Kosovës ka rreth 7.500 të punësuar. Për shkak të mungesës së punonjësve të kualifikuar, mungësia e aplikimit shkakton vjedhje dhe situata të mospagesës së energjisë elektrike. Korporata Energjetike e Kosovës duke shkuar në themel të këtyre problemeve dhe duke ndërtuar një strukturë efektive institucionale mund të sigurojë rritje të performancës në sektorin e energjisë. Mirëpo pa mbështetjen e qeverisë dhe organeve të drejtësisë nuk ka mundësi të eliminimit të këtyre problemeve.

Në vitin 2004 nga Ministria e Energjisë dhe Burimeve Minerale, në emër të strategjisë dhe politikave të sektorit të energjisë është nxjerrur legjislacioni i përdorimit të energjisë racionale. Para së gjithash është projekti i termocentralit Kosova e Re.

4.LEGJISLACIONI

Ligji i Energjisë

Dokumenti themelor që përcakton politikat energjetike dhe të planifikimit për zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë është Strategjia e Energjisë. Strategjia e Energjisë do të:

- sigurojë furnizim të sigurtë, të qëndrueshëm dhe kualitativ me energji;
- promovojë balancin afatgjatë në zhvillimin e sektorit të energjisë duke marrë parasysh paqëndrueshmëritë (lëkundjet, fluktuacionin) në konsumin e energjisë;
- mundësojë shfrytëzimin maksimal të burimeve të energjisë në disponim në Kosovë;
- promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- sigurojë përdorimin efikas të energjisë;
- mbrojë konsumatorët e energjisë;
- promovojë investimet në sektorin e energjisë;
- promovojë konkurrencën në sektorin e energjisë bazuar në parimet e jo diskriminimit dhe transparencës;
- lehtësojë lidhjen e sistemit të energjisë së Kosovës ose pjesëve të saj me sistemin e energjisë të Europës ose me sistemet e vendeve të tjera.

Ligji i Autoritetit të Rregullatorit të Energjisë :

Ligji i Autoritetit të Rregullatorit të Energjisë së bashku me Sektorin e Energjisë që të jenë efektive , të punojn rregullisht dhe të sigurojnë furnizim me energji pretendojnë të marrin një rol aktiv nga organi i pavarur rregullativ për zgjedhjen e problemeve.

- Rregullimi i punëve transparente dhe jo-diskriminuese të tregut të energjisë;
- Sigurimi i kritereve që janë transparente dhe të hapura për dhënien e licencave dhe autorizimeve;
- Ndalimi i aplikacioneve konkurente;
- T'i sigurojë zgjidhje procedurave të përshtatshme për zgjedhjen e kontesteve;

Përveç kësaj , Ligji i Autoritetit Rregullativ të Energjisë përfshinë afatin e mandatit , detyrat , dhënien e autorizimeve dhe rregullimin e çmimeve.

Ligji I Energjisë Elektrike :

Në prodhim , transmetim , shpërndarje dhe treg të energjisë elektrike , merret si qëllim zbatimi i kërkesave të vendosura nga ligji dhe rregullimi i tregut të energjisë.

- Ka për qëllim konkurrencën e Energjisë Elektrike dhe zhvillimin e një tregu të përhershëm;
- Të garantojë kushtet për një energji elektrike të sigurtë , të përhershme , efikase dhe me furnizim të vazhdueshëm;
- Është objektivi kryesor i Ligjit të bëjë rregullimin e transmetimit , zonës së shpërndarjes dhe sistemit të energjisë elektrike.

5. TREGU I ENERJISË ELEKTRIKE :

Pothuajse i tërë sektori i energjisë në Kosovë është i përbërë nga energjia elektrike. Dallimi kryesor që ndan sektorin elektrike nga sektorët e tjerë është se çmimet janë fleksibile ndaj kërkesës së energjisë. Domethënë në mekanizmin normal të tregut , kur një çmim është shumë i shtrenjtë atëherë kërkesa për atë mall zvogëlohet dhe drejtohet rreth mallit të zëvendësuar. Meqë , në sektorin elektrik në Kosovë ka mungesë të zëvendësimeve dhe mungesë të furnizimit , tregu i energjisë drejtohet në këtë mënyrë. Në përgjithësi , tregu i energjisë duhet të përcaktoj limitin e lartë të çmimit. Megjithatë , ky limit i sipërm është temë diskutimi se në bazë të ckafit do të vendoset. Kur shikojm në aspektin e investitorëve , objektivi kryesor i tyre është investimi për rrezikshmëri dhe parashikimi i kohëzgjatjes së kthimit të investimeve. Prandaj , realizimi i prodhimit nën prodhimtarinë optimale për investitorët do të thotë rrezik më i ulët . Për të prodhuar mbi nivelin optimal të prodhimit , nuk siguron fitim për investitorin. Mirëpo , kur bëhet prodhimi më pak se ajo optimale dhe ngritja e çmimeve zgjat më gjatë , kjo gjendje bëhet më e dobishme për investitorin.

Një tjetër çështje e rëndësishme në sektorin e energjisë është : Investitorët në një vend presin kohën kur ka nevojë për investime të kapaciteteve të reja domethënë dëshira për të investuar në atë kohë kur përfitimi është i qartë. Mirëpo në ditët e sotme , duke pasur parasysh përparimin teknologjik dhe normat e rritjes së popullsisë , veçanërisht në sektorin e energjisë kërkesa është vazhdimisht në rritje.

5.1 ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE

Qmimet e energjisë elektrike në Kosovë ndryshojn sipas sezonës së verës dhe dimrit. Sezoni i dimrit fillon në fillim të muajit Tetor dhe përfundon në fund të muajit Mars. Kurse sezoni i verës fillon në fillim të muajit Prill dhe mbulon periudhën deri në fund të muajit Shtator. Në të njëjtën kohë, në sezonin e dimrit dhe verës aplikohen tarifa të ulëta dhe të larta të energjisë elektrike.

Qmimet e energjisë elektrike për njësi kWh ndryshon sipas kategorive të ndryshme. Për shkak të familjeve , industris së bimëve , institucioneve publike , agjencitë e shëndetit etj, kanë norma të ndryshme të çmimeve të energjisë elektrike. kWh mesatare e energjisë elektrike dorëzuar konsumatorit të fundit është 5,7 €/ cent.

5.2 PRODHIMI DHE KONSUMIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Pothuajse i gjithë prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë , prodhohet nga Termocentralet Kosova A dhe Kosova B. Përvec kësaj , me ekzistimin e hidrocentraleve të vogla , prodhohet një sasi e vogël e energjisë elektrike.

Vitet e prodhimit të energjisë elektrike :

Vitet	Prodhimi i energjisë elektrike TS ve HS (GWh)	Normat e prodhimit të energjisë elektrike gjatë vitit të kaluar
2002	3.151,80	-
2003	3.221,00	2,20 %
2004	3.481,10	8,07 %
2005	3.999,80	14,90 %
2006	3.970,50	-0,73 %
2007	4.903,40	8,54 %
2008	4.505,70	-8,11 %
2009	4.974,84	9,7 %

Burimi I informacionit : Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Konsumimi total i energjisë elektrike gjatë vitit 2009 në Kosovë ishte 5868 GWh. Megjithatë , me rritjen e industrializmit në periudhën e ardhshme parashihet të ketë rritje të dukshme në kërkesen për energji elektrike.

Prodhimi i energjisë elektrike	Furnizim GWh	Konsumim GWh	Konsumimi i energjisë elektrike
Termocentralet	4855	5420	Konsumimi total
Hidrocentralet	119	274	Eksporti
Importi	767	174	Humbjet e transportit
TOTALI	5741	5868	TOTALI

Në anën tjetër , në Kosovë gjatë periudhave të ndryshme të vitit aplikohet ndërprerje e energjisë elektrike. Prodhimi dhe importi për furnizim me energji elektrike nuk është i mjaftueshëm që të përmbush kërkesën.

5.3 HUMBJET NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë është I rëndësishëm reduktimi i humbjeve komerciale për kostot e larta. Në Kosovë , 44 % në vit që dalin nga rrjeti i shpërndarjes , është përjetuar humbje e totalit të 99 milion €të të ardhurave. Nëse Korporata Energjetike e Kosovës do të mund të ndalonte këtë , ajo do të fitonte 90 milion të ardhura vjetore më të cilat do të përmbushte obligimet për importin e energjisë , investimet e kapitalit të bëra me afat dhe një pjesë të harxhimeve të publikut .Korporatës Energjetike të Kosovës për periudhën 1999-2008 nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës i janë ndarë 459 milion €kurse nga Agjencia Evropiane për Rindërtimë (EAR) / Komisioni Evropian (KE) nga fondet e donatorëve ndërkombëtarë janë ndarë 593 milion €.Këto transfere , përfaqësojnë korrespondohen me 100 milion €në vit.

Transmetimi , shpërndarja dhe faza e përdorimit të energjisë elektrike , ndërmjet viteve 2002 – 2008 kishte norma mesatare të humbjes prej 45,6 % . Norma mesatare vjetore e humbjes së energjisë elektrike është 1.885,5GWh.

Normat e humbjes se energjisë elektrike mes viteve 2002 -2008:

Vitet	Humbjet e energjisë elektrike GWh	Normat e humbjes se energjisë gjate vitit te kaluar
2002	1.369,00	-
2003	1.539,00	12,42 %
2004	1.797,00	16,76 %
2005	2.159,10	20,15 %
2006	2.127,30	-1,47 %
2007	2.205,10	3,66 %
2008	1.999,70	-9,31 %
2009	2.000,00	

Burimi I informacionit : Korporata Energjetike e Kosovës

Për shkak të gjendjes së keqe të infrastrukturës së pranishme dhe për shkak të mungesës së menaxhimit dhe kapacitetit të punëtorëve është parë i nevojshëm zhvillimi i performancës në sektorin e energjisë. Problem themelor janë faturimi dhe humbjet. Këto humbje : 16.2 % humbjet teknike , 22.4 % vjedhja dhe 21.4 % humbjet tjera komerciale.

Përshkrim / Vitet	<u>2006</u>	<u>2007</u>	<u>2008</u>	<u>2009</u>
Përqindja e faturimit të energjisë elektrike të konsumuar	60%	70%	80%	80%
Përqindja mbledhjes së të ardhurave nga faturat	74%	77%	76%	81%
Përqindja e të ardhurave nga energjia elektrike e konsumuar	51%	54%	61%	64%

6. AKTIVITETET E SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË DISPOZICION

Termocentralet

Kosova ka dy termocentrale. Kosova A dhe Kosova B. Kosova A përbëhet nga pesë blloqe dhe ka një kapacitet prej 800 MW. Blloku A1 dhe A2 janë ndërtuar si dy blloqe të vogla në vitin 1960. Blloku A1 në vitin 1962 ka filluar të punojë me 65MW , kurse A2 në vitin 1965 me 65 MW. Në vitet 1970-1971 janë ndërtuar dy blloqe më të mëdha A3 dhe A4. A3 200 MW, A4 200 MW kurse A5 ka 210 MW fuqi të prodhimit.

Termocentrali Kosova B ka dy blloqe dhe 680MW kapacitet. Eshtë ndërtuar në mes të viteve 1983-1984. Të gjitha blloqet e dy termocentraleve veprojnë me kapacitetet e tyre të instaluar dhe me afërsinë e burimit të linjit. Në studimin e blloqeve të Kosovës B , për shkak të problemeve elektrike dhe mekanike ka ndërprerje të shpeshta. Gjithashtu , pengohet funksionimi i të gjitha blloqeve të Kosovës A në të njejtën kohë për shkak të mungesës së furnizimit të mjaftueshëm me linjit. Gjatë periudhës së gjashtë mujorit të parë të 2009 me 2 Qershor ka filluar riparimi dhe mirëmbajtja e bllokut B1 në Termocentralin Kosova B. Gjatë këtij gjashtë mujori ka punuar më pak se blloku B2. Gjatë të njejtës periudhë kanë punuar blloqet A3 dhe A4 te Termocentralit Kosova A. Blloku A5 pritët që të hyjë në funksion me kapacitet të plotë në dhjetor të vitit 2009. Për blloqet A1 dhe A2 po shqyrtohen mundësit për aktivizim.

Në vitin 2007-2008 gjatë sezonit të dimrit kapaciteti i prodhimit të energjisë duke përfshirë edhe hidrocentralet është 680 mijë MW. Si rezultat i kërkesës së 1 milion e 081 mijë MW së bashku me humbjet energjetike janë importuar 540 GWh energji elektrike.

Hidrocentralet :

- Hidrocentrali i Radavcit
- Hidrocentrali Ujman
- Hidrocentrali Lumbardh

Nga tre hidrocentralet prezente në Kosovë , prodhimi i energjisë elektrike në këto hidrocentrale është i kapacitetit të ulët. Në vitin 2005 113,5 GWh , në vitin 2006 127 GWh , në vitin 2007 58,1 GWh , në vitin 2008 47,3 GWh energji elektrike janë prodhuar.

Bilanci i energjisë elektrike per vitet 2005-2008

	2005		2006		2007		2008	
	GWH	%	GWH	%	GWH	%	GWH	%
Prodhimi	4.494,30	100	4.535,70	100	4.956,40	100	5.175,60	100
Pordhimi Vendor	4.003,70	89,1	3.977,90	88,1	4.333,00	87,4	4.528,10	87,5
Termocentrali	3.890,20	86,6	3.870,90	85,3	4.274,90	86,3	4.480,80	86,6
Hidrocentrali	113,5	2,5	127	2,8	58,1	1,2	47,3	0,9
Importi	490,6	10,9	537,8	11,9	623,4	12,6	647,5	12,5
Konsumimi	2.335,20	52	2.408,40	53,1	2.751,30	55,5	3.175,90	61,4
Konsumim lokal	2.109,40	46,9	2.155,10	47,5	2.391,40	48,2	2.940,90	56,8
Konsumim publik	1.447,90	32,2	1.458,60	32,2	1.503,50	30,3	1.666,90	32,2
Konsumim komercial	661,5	14,7	696,9	15,4	887,9	17,9	1.274,00	24,6
Eksporti	225,8	5	253,3	5,6	359,9	7,3	235	4,5
Humbjet	2.159,10	48	2.127,30	46,9	2.205,10	44,5	1.999,70	38,6

Burimi I informacionit : Raporti I Bilancit të Energjisë së Kosovës për vitet 2002-2008

7. RRJETI I TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES

Me mos investimin për shumë vite në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes apo për shkak të investimeve të mangëta , rezultojn humbje teknike të mëdha në sistem. Duke pasur parasysh popullatën e Kosovës bilanci i normave të përgjithshme të humbjes duhet të jenë 2,5 – 3 % energjia e elektrike e transmetimit dhe 8 % shpërndarja , mirëpo ato janë 16-18 % shpërndarja dhe 3,7 % transmetimi. Si rezultat përfundimtar , po përjetohen humbje të mëdha teknike për këtë arsye duhen investime të mëdha për t'i ndaluar.

Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike i Termocentraleve Kosova A dhe Kosova B është i gjatë 51.969 km. Mirëpo , një nga problemet më të rëndësishme të humbjes së energjisë elektrike është se në Kosovë përafërsisht 29,000 km ka rrjet të shpërndarjes i

cili është vjetërsuar dhe për shkak të mungesës së fondeve të mirëmbajtjes nuk po bëhet rregullimi i tij.

Total rrjeti i transmetimit është rreth 1,200 km. Rehabilitimi i sistemit të transmetimit dhe zgjerimi janë kryer rreth viteve 1991 – 2001 kurse investimet pasuese në përgjithësi janë bërë për rregullimin e dëmeve të shkaktuara në kohën e pasluftës.

Gjatësia e rrjetit të shpërndarjes së energjisë së prodhuar në Kosovë ose importit të energjisë elektrike është si vijon:

- 35 kV 776.8 km
- 20 kV 331.7 km
- 10 kV 12873.3 km
- 0.4 kV 37988.9 km

Sistemi i transmetimit në Kosovë është shumë i rëndësishëm në drejtim të besnikërisë rajonale. Ka besnikëri rajonale me Serbinë , Maqedonin dhe Malin e Zi me 400 kV kurse me Shqipërinë 220 kV. Për tregun rajonal të energjisë varësia e transmetimit në Kosovë në të njëjtën kohë për ofrimin e sigurimit me furnizim është një pikë e rëndësishme.

8. BILANCI I ENERGJISË : SHPËRNDARJA SEKTORIALE DHE BURIMORE E FURNIZIMIT DHE KËRKESËS SË ENERGJISË TOTALE 2009

Kur shikojm shpërndarjen e energjise sektoriale të konsumimit të energjisë elektrike shofim se pjesa më e madhe përdoret për sektorin e strehimit. Sipas Raporti vjetor (2009) të Ministris së Energjisë dhe Minierave për Bilancin e energjisë , konsumimi i energjisë në Kosovë ishte 46 % sektori i banimit , me pas 26 % i transportit dhe me 17 % sektori industrial.

Shpërndarja sektoriale e konsumimit të energjise në Kosovë është si vijon :

SEKTORI	Nafta ekuivalente e Kiloton ktoe (kiloton of oil equivalent)	Përqindja (%)
Sektori I Industrisë	243,91	17
Sektori I strehimit	654,71	46
Shërbimi	134,60	9
Bujqësia	27,71	2
Transporti	365,60	26
TOTAL	1426,53	100

Nëse shikojm burimet e përdorura për të përmbushur kërkesën totale për nevojat e energjisë shofim se karburanti me 35 % zënë vendin e parë. Energjia e ripërtërirë në

Kosovë mund të thuhet së është e pa ekzistueshme. Pas karburantëve me 30 % zënë vend druri dhe derivatet e saj kurse me 25 % merr pjesë energjia elektrike.

Shpërndarja e burimeve të energjisë është si vijon:

Burimi i energjisë	ktoe olarak toplam tüketimdeki payı	Përqindja (%)
Qymyri	116,96	8,20
Karburante	503,60	35,30
Druri dhe Derivatet e saj	428,56	30,04
Biokarburantet	0,11	0,01
Energjia	368,44	25,83
Ngrohja qendrore	8,86	0,62
TOTAL	1426,53	100

Në Kosovë , çdo vit është rritur përqindja e kërkesës për energji. Për shkak të industrializimit dhe gjallërisë së prodhimit , në vitet e ardhshme pritet që kjo rritje të zhvillohet më shpejt. Gjatë gjashtë viteve të fundit është realizuar 3.7 % rritje e kërkesës për energji vjetore.

Bilanci i konsumimit të energjisë totale sipas viteve :

Vitet	Konsumimi i energjisë me ktoe	Rritja e përqindjes sipas viteve
2003	1,154.18	-
2004	1,161.43	0,63
2005	1,309.10	12,72
2006	1,330.04	1,60
2007	1,297.50	-2,45
2008	1,369.09	5,52
2009	1,426.53	4,19

Siç mund të shihet në tabelën më poshtë , sektori industrial kryesisht funksionon në bazë të energjisë elektrike. Një nga mungesat më të rëndësishme është ajo e gazit natyror.

Shpërndarja e përqindjes sipas sektorëve të përdorimit të burimeve të energjise elektrike :

Energjia/sektori	Industriale	Strehim	Shërbim	Transport	Bujqësi
Rryma	40	32	40		22
Karburantët	24	5	20	Dizel 69 97 Benzin 21 Kerozin 7	40,5
Qymyri	23	5	26		8
Druri	13	57	11		29,5
LPG				3	

Sistemi qendror		1	2		
Energjia diellore					

Njoftim: Të gjitha tabelat e kësaj pjese janë përgaditur nga Raporti vjetor I Ministris së Energjisë dhe Minierave për bilancin e energjisë.

9. RITJJA E EFIKASITETIT TË ENERGJISË

Efikasiteti i energjisë mbulon çdo fazë të punës në mënyrë efektive që nga prodhimi , transmetimi deri tek konsumimi. Rritja e efikasitetit të energjisë bëhet edhe përmes konsumimit të energjisë. Me kurrsimin e energjisë , sidomos në vendet në zhvillim është e mundur zgjidhja e problemeve të rëndësishme të energjisë. Prodhimi i energjisë së fituar nga kursimi dhe efikasiteti është shumë më i shtrejtë . Prandaj , në vendet në zhvillim burimet e kufizuara të investimeve të energjisë dhe rritja e vazhdueshme e kërkesës për energji rrisin rëndësin e efikasitetit të energjisë.

Energji e kurrsyer nuk është ndërprerja e energjisë .Vendosja e rregullave të konsumatorëve dhe përdorimi i metodave të përmirësimit mundësojn përdorim më efikas të energjisë.

Për të mbështetur efikasitetin e enegjisë në Kosovë , duhet të formohet një Agjencion për Efikasitetin e Energjisë brenda kornizave themelore ose të bëhet rregullimi i atij ekzistues me politikat e efikasitetit të energjisë. Për vetëdijësimin e qytetarëve si rekomandime paraprijnë fushatat. Masat mbrojtëse për efikasitetin e energjisë dhe kursimin e energjisë janë : izolimi i dryerve dhe dritareve , izolimi i objekteve , ulja e normës së përdorimit të drurit dhe mbrojtja e sipërfaqeve pyjore , metodat më efikase të energjisë si akumulatorët e ngrohjes apo ngrohja moderne me pompa dhe zgjerimi i tregut LPG.

10. RËNDËSIA E ENERGJISË DHE TEKNOLOGJISË

Problemet në sektorin e energjisë , në të njëjtën kohë zhvillimet teknologjike në këtë fushë , çojn nëeksplorimin e burimeve alternative të energjisë. Meqë Kosova nuk ka kapacitet të mjaftueshëm në fushën e zhvillimit teknologjik , ajo duhet të : fillojë ndërtimin e termocentraleve të reja për të zgjidhur problemin e energjisë , rehabilitimin e e tremocentraleve ekzistuese dhe marrjen e prodhimit maximal nga burimet vendore të linjitit . Nga burimet alternative të energjisë , prodhimi i energjisë elektrike nga energjia e erës është politikë bazë.

11. ENERGJIA DHE MJEDISI

Për mirëqenien sociale dhe zhvillimin ekonomik konsumimi i energjisë është i domosdoshëm mirëpo kjo çon në ndotje të mjedisit. Me qëllim të harmonizimit të standardeve të mjedisit me standardet e Bashkimit Evropian , qeveria e Kosovës ka nxjerrur Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji per Mbrojtjes e Mjedisit përfshin këto objektiva : ofrimi i një mjedisi të shëndosh jetësor për popullin e Kosovës , përdorimi

racional i burimeve natyrore dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së publikut në lidhje me mbështetjen e mjedisit.

Lidhur me prodhimin , transmetimin dhe shpërndarjen e energjise , të gjitha investimet duhet të rregullohet sipas planifikimit të veçant dhe vlerësimet duhet të bëhen duke marrë parasysh ndotjen e ambientit.

12. PROJEKTET E PLANIFIKUARA DHE PROCESI I REALIZIMIT

Kosova tashmë është duke punuar për disa projekte të energjisë , ku njëri prej tyre është i termocentralit dhe dy tjera të hidrocentraleve.

Projekti i Termocentrali “ Kosova e Re “

Termocentrali “ Kosova e Re “ planifikohet të ndërtohet me një kapacitet të energjisë prej 500 + 500 MW dhe dy blloqe. Objektivi I këtij projekti është se përveç termocentralave ekzistuese te energjisë termike me depozitat e linjtit do të furnizojë edhe termocentralin e ri me linjit dhe do të bëjë zhvillimin e fushës së linjtit në Sibovc . Pritet që ditëve të ardhshme të caktohet firma e cila do të fitojë tenderin e projektit i cili është në proces.

Projekti I Hidrocentralit te Zhurit

Hidrocentrali i Zhurit gjatë kohës së Ish-Jugosllavisë qëndroi në rend të ditës pastaj në vitin 2000 u bë rivlerësimi i tij. Ai ka një kapacitet prej 300 MW dhe pritet të kushtojë 287 milion . Me modelin e bërjes , veprimit dhe transmetimit synohet t'i ipet me koncesion sektorit privat me afat 40 vjecar. Vazhdimi i procesit të tenderit për projektin në fjal pritet të merr nënshkrimin përfundimtar në çerekun e pare të 2011-tës.

Projektet tjera : 16 Hidrocentrale të vegjël

Projekti i cili ka kapacitet total prej 63 MW janë të dizajnuara të ndërtohen në formë të hidrorcentraleve të vegjël në lumenj të vegjël. Kostoja totale e investimeve është vlerësuar të jetë 38 milion.

PRIVATIZIMI I SHPERNDARJES SE ENERGIJE

Korporata Energjetike e Kosovës në projektin e privatizimit ka 51,969 km rrjet te shpërndarjes dhe 327,000 abonentë të regjistruar. Opinioni i përgjithshëm i këtij procesi është se ky process nuk është i thjeshtë dhe vendet që kryejn këtë process duhet të përfitojn. Procesi i tenderit të këtij projekti është në vazhdim.

PËRFUNDIMI

Ndër çështjet më të rëndësishme për parandalimin e humbjeve të energjisë janë bërja e investimeve të reja në Kosovë , frunizimi i mjaftueshëm me energji të qëndrueshme , shpenzimet e energjisë dhe kontrolli i çmimit. Eshtë e qartë se qeveria për shkak të mungesave të energjisë synon që me projektet Kosova e Re dhe miniera e Sibovcit të zgjidh këto probleme.

Duke pasur parasysh ndërprerjet e vazhdueshme , qeveria për projektet e planifikuara të fillojë në 2010 duhet të përgadisë një plan të veprimit të shpejtë. Deficiti i energjisë dhe mungesa e burimeve alternative të energjisë në anën tjetër , përbën një pengesë të re dhe serioze në investimet e industrisë ,nga ana tjetër ndikon negativisht në perspektivën e Kosovës.Prandaj si qeveria e Kosovës dhe si prania ndërkombëtare në Kosovë i japin rëndësi projekteve të energjisë. Edhe nëse projekti Kosova e Re dhe projekti i hidrocentraleve i sjellin zgjidhje afat-gjate energjisë në Kosovë , duhet të gjejë mënyrën për t'u përfshirë në sistem dhe rrjetet e transmetimit të energjisë ndërkombëtare.